



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 597/24 Dt. 09.09.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Procesverbali për- Projekt-Rregulloren për dhënien e titujve,  
dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Plotësim-  
Ndryshimin e Rregullores për mbikëqyrjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e objekteve publike  
sportive dhe kulturore .Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në  
përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Me **31.05.2024**, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e  
Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit. Anëtarët e  
këtij grupi janë: Blerim Rakaj, anëtar; Laura Kelmendi, anëtare; Haziz Krasniqi, anëtar; Idriz  
Kryeziu, anëtar; Vetan Xhemaj, anëtar; Edona Krasniqi, anëtare; Xhafer Ponik, anëtar; Fatlum  
Berisha, anëtar, Eroll Shabani anëtar (OJQ EcMaNdryshe).

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **27.08.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-Rregullore-per-Dhenien-e-Dekoratave-nga-Komuna-e-Prizrenit.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42593>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-per-dhenien-e-dekoratave-nga-komuna-e-prizrenit/>

**Me 27.08.2024**, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 06.09.2024**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-tituj-dekorata-dhe-cmime-nderi-nga/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/bPyEnjT8Cb3uetP6/?mibextid=oFDknk>

### **Konsultimi ka filluar në orën 11:10**

Ymer Berisha, udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun tha se edhe ky dokument do të ketë bashkautorësinë me qytetarët dhe nga qytetarët presim kërkesa, komente, ide dhe sugjerime në mënyrë që ky dokument të jetë sa më përmbajtjesore, profesional dhe lehtë i zbatueshëm.

Për mbajtjen e këtij konsultimi, zyrtarët përgjegjës do të mbajnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe më pas edhe raport për gjithë ecurinë e këtij procesi, të dy dokumentet do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës, në mënyrë që të kemi memorie institucionale dhe kurdo që qytetari ka dëshirë të dijë se çka është është kërkuar në këtë konsultim mund ti çaset webfaqes dhe të gjej dokumentin zyrtar.

Kerkesat e qytetarëve të parashtruara gjatë mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë:

#### **Haki Reshtana:**

- 1.Cilët janë kriteret për ndarjen e çmimeve dhe dekoratave
- 2.Pse në komision nuk është asnjë anëtar i komunitetit turk

#### **Shukri Quni:**

- 1.Kërkoj të informohet për arsyen e rritjes së numrit të çmimeve dhe dekoratave që ndanë komuna
- 2.Kërkoj që çmimi Xhevat Berisha të ndahet për çdo vjet për arsimtarët dhe profesorët më të suksesshëm

#### **Bashkim Gashi:**

- 1.Kërkoj që të saktësohet periudha e dhënies së dekoratës
- 2.Dekoratat të mund të jepen më shumë se 1 personi për të njëjtin kontribut

**Shukrije Berisha:**

1.Mirë është që të ndahet dekoratë që lëngojnë nga sëmundjet me kancer

**Resmije Krasniqi**

1.Kërkoj nga komisioni ti vizitohet OJQ-të dhe të diskutojnë për çmime

**Konsultimi ka përfunduar në orën 11:45.**

Procesmbajtës:  
HARIE KRASNIQI

